Maskat terrorizojnë me armë fshatin në Bulqizë, hyjnë në lokal e qëllojnë brutalisht të riun

3 ditë më parë

Një ngjarje e rëndë është shënuar 3 netë më parë në fshatin Gjoricë e Poshtme të Bulqizës, por që vetëm sot është bërë publike. Persona të maskuar dhe të armatosur kanë hyrë në një lokal të fshatit ku gjendeshin rreth 20 persona, ndërsa kanë dhunuar rëndë një 25-vjeçar. Kjo ngjarje bëhet e ditur nga një banor, i cili është edhe anëtarë i pleqësisë së fshatit.

Gëzim Miftari thotë se mes personave që panë terror ka qenë edhe djali i tij në lokal. Ai tregon se katër persona të armatosur me armë automatik dhe pistoleta, të maskuar, janë futur në lokal, ndërsa një prej tyre qëndroi tek dera për të ruajtur. Miftari tha për gazetarin e 'News24' dhe 'BalkanWeb' Enver Doçi se 3 autorët e tjerë kanë hyrë brenda duke kërkuar që të gjithë të zvarriten në tokë, ndërsa kanë nisur të dhunojnë të riun me inicialet F.A., duke e goditur me qytën e armës. Pasi e kanë dhunuar fort ata janë larguar ndërsa personat e gjendur aty kanë transportuar të riun në spitalin e Dibrës në gjendje të rëndë shëndetësore.

"Kam qenë ndoshta jo prezent, por kam qen pas 10 minutash, pasi isha afër. brenda në lokal ishte djali im. Ngjarja e rëndë, s'ka ndodhur asnjëherë në fshatin tonë. kanë ardhur 3-4 persona, të armatosur dhe me maska dhe kanë hyrë në lokal. Ka qenë rreth orës 21:30 e darkës. ata iu thanë që të shtriheshin përtokë. një prej tyre e masakruan një djalë duke pirë kafe. Sot ai djali është në spital, në gjendje kritike për jetën. është në spitalin e Peshkopisë. unë i bëj thirrje Edi Ramës, do i dërgoj një mesazh, atij dhe ministrit të Drejtësisë, prokurorit të Përgjithshëm, presidentit të Republikës, që të marrin masat. pasi do armatosemi të gjithë si fshat, dhe nuk do kërkojmë më ndihmën e tyre. S'do lejojmë as policinë e shtetit, asnjë tjetër. Një masakër e tillë ka ndodhur në Kosovë. kanë bërë rreth 10 minuta. jam 56-vjeç, nuk është parë kjo në historinë tonë. Nëse donte policia e shtetit, mund ta kishte zbardhur. Ne do të armatosemi të gjithë dhe kur të vijë policia e shtetit, do t'i vrasim të parët. Unë futem në burg, 10 vite, 100 vite. Unë them se policia e shtetit i di këto gjëra. ne kemi humbur besimin tek shteti.",- tha Miftari.

Ai dhe banorët e tjerë të fshatit Gjoricë e Poshtme kërkojnë që autorët të arrestohen pasi kanë ushtruar një terror të madh, duke frikësuar të gjithë fshatin.

#arme #bulqize #kryeplak #maska

Nga kategoria

"Situata shqetësuese", Pëllumb Pipero tregon çfarë masash janë të domosdoshme

Vetëvaret një person në Bulqizë

Të shtëna me armë zjarri drejt kompleksit, dalin detajet e para

Të shtëna me armë në Fier gjatë natës, policia zbulon shkakun dhe autorin

Përplasje me armë zjarri në Elbasan, një i lënduar

Detaje nga masakra në Krujë/ Si nisi sherri në kafe, autori konflikte me viktimat dhe herë të tjera

Më të lexuarat e javës

Debati/ Moderatoret seksi të ekraneve, stimulim për "për lukuninë e uritur të burrave"
5 DITË MË PARË

Dosjet e vjedhjes së votave në Shijak e Dibër, PE i kërkon Shqipërisë vënien para drejtësisë të përgjegjësve
4 DITË MË PARË

Thaçi nën akuzë, një lojë politike dhe një bast i humbur
3 DITË MË PARË

Kushtet e BE / Rama si kuzhinjer për budallenj
3 DITË MË PARË

"Der Standard": Thaçi po përpiqej për një "marrëveshje të ndyrë"
2 DITË MË PARË

Analiza/ Kur Rama vizatonte harta me ndryshim kufijsh
4 DITË MË PARË

Debati për teatrin zhvendoset në Danimarkë/ Bjarke Ingels i përgjigjet gazetës Politiken
5 DITË MË PARË

Vuçiç fiton në zgjedhjet pa opozitë/ Cila qe loja e shqiptarëve?
5 DITË MË PARË

Lini një Përgjigje

ADRESA JUAJ EMAIL S'DO TË BËHET PUBLIKE.

Koment

Emër

POSTOJE KOMENTIN

TË FUNDIT

KTHEHU

Video/ "Dygualdo" e De Ligt: poker i Juventus ndaj Lecce e +7 nga Lazio
7 ORË MË PARË

Putin dhe Macron, 2 orë në telefon: Folëm edhe për tensionet në Ballkan
8 ORË MË PARË

Carl Bildt: Thaçi mund të arrestohet
8 ORË MË PARË

Japonia hedh dyshime: Kim Jong-un ka vdekur nga koronavirusi
8 ORË MË PARË

Policia italiane gjen pas 32 vitesh motorin e vjedhur, ndalohet shqiptari
8 ORË MË PARË

Video/ Shikoni talljen epike të televizionit britanik ndaj Gary Neville për profecinë e bërë ndaj Liverpool
8 ORË MË PARË

Kërkoni

Kërko ...

Ju rekomandojmë

Putin dhe Macron, 2 orë në telefon: Folëm edhe për tensionet në Ballkan

Carl Bildt: Thaçi mund të arrestohet

Japonia hedh dyshime: Kim Jong-un ka vdekur nga koronavirusi

Policia italiane gjen pas 32 vitesh motorin e vjedhur, ndalohet shqiptari

DASH "shuplakë" Shqipërisë: Nuk heton zyrtarët trafikantë të qenieve njerëzore

Aksident zinxhir, përplasen 3 makina në Tiranë

"Der Spiegel": Goditje për "Gjarprin"

Konfirmohen 10 fluturime nga Rinasi për nesër

©2019 Copyrighted Lapsi.al
Politika e Privatësisë
Dev by Aplikacione.com